



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMLORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:234516

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06380982

C.nr.669/2019

GJYKATA THEMLORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil - me gjyqtarin Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.M., me vendbanim në fshatin S.-V., kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KESCO-Distrikti në Mitrovicë, të cilën e përfaqëson L. V., në çështjen juridike me objekt kontesti shlyerje borxhi, jashtë seance, me datë 31.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. HUDHET POSHTË SI E PALEJUAR padia e paditësit A.M. C.nr.669/2019, e datës 30.09.2019, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KESCO-Distrikti në Mitrovicë, në çështjen juridike me objekt kontesti shlyerje borxhi.
- II. Secila palë bart shpenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësi, ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datën 30.09.2019, kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar që gjykata ta detyroj të paditurën që ta shlyej borxhin nga njëtori elektrik 17692975, në shumën prej 705.10 euro, të ngarkuara në emër të rikthimit të humbjeve me datë 06.05.2016 në emër të paditësit.

Gjykata për këtë çështje me datë 23.10.2024, ka caktuar seancën përgatitore në të cilën paditësi ka deklaruar se ai ka bërë kërkesë në KEDS për vendosjen e njëtorit elektrik në shtyllat jashtë

shtëpisë siç vepohet me të gjithë qytetarët, mirëpo e paditura nuk ka vepruar në këtë formë por zyrtarët e saj në prill-maj 2016, ka qenë tek shtëpia (depoja) që ka qenë e pabanueshme, mirëpo është furnizuar nga njëtori elektrik i cili është në emër të tij (9028973), pavarësisht se asnjë mjet nuk ka qenë i kyçur dhe në emër të humbjeve pas këtij inspektimi është përcaktuar në mënyrë paushalle shuma prej 705.10 euro, ndërsa ka shtuar lidhur me këtë përpos padisë së dorëzuar në gjykatë nuk ka bërë ndonjë ankesë tek e paditura apo tek Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike (ZRRE).

Në anën tjetër përfaqësuesja e të paditurës ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se shuma prej 705.10 euro është paushalle sepse kjo shumë është caktuara duke u bazuar në Procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike të miratuar nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të padisë dhe deklarimeve në seancë të palëve, jashtë seance ka marrë aktvendim si në dispozitiv të këtij aktvendimi, kjo duke u bazuar në nenin 387 par 1, pika w), sipas të cilës thuhet se *“Me qëllim që çështja të përgatitet sa më mirë për t’u zgjidhur shpejt e drejt, gjykata që nga momenti i arritjes së padisë e deri në momentin e caktimit të seancës për shqyrtim kryesor të çështjes me aktvendim vendosë për: w) pushimin e gjykimit kur hedhet poshtë padia apo kur tërhiqet ajo, si dhe të gjitha çështjeve tjera që kanë të bëjnë me drejtimin e gjykimit”* si dhe nenit 391, a) *“Pas shqyrtimit paraparak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: a) çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore”* dhe atë për arsytet si më poshtë.

Sipas nenit 16 par.1.1, të Ligjit Nr.03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi pretendon se padrejtësisht është ngarkuar me borxh nga e paditura (06.05.2016), e në të njëjtën formë është rregulluar edhe me nenin 17 par.1.1, të Ligjit Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është bërë padia (30.09.2019), është paraparë që *“Rregullatori harton procedura për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë ankesat: 1.1. nga konsumatorët kundër të licencuarve, në lidhje me shërbimet e ofruara”*. Në kontekst të kësaj, sipas [Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë](#), të miratuar nga ZRRE më 16.03.2017, me nenin 2, par 2.3 të saj ka paraparë që *“Rregulla përcakton termat, kushtet dhe procedurat në lidhje me zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë, në mënyrë që: të zgjidhë kontestet midis konsumatorëve dhe furnizueseve, si dhe midis të licencuarve të energjisë”* dhe po ashtu me këtë rregullore përcaktohet edhe procedura e mënyra e dorëzimit të ankesës së konsumatorit (Neni 7

dhe 8) procedura e vendimmarrjes së ZRRE-së për ankesat e paraqitura (Neni 9, 10, 17 dhe 18) ku përfshihet edhe e drejta e konsumatorit për të iniciuar konfliktin administrativ (Neni 18 par 5)

Prandaj pas analizimit të kërkesëpadisë së paditësit, provave të propozuara nga ai dhe deklaratimet e palëve në seancën përgatitore e të gjitha këto në raport me bazën ligjore që e rregullon procedurën e raportit në mes paditësit si konsumator dhe të paditurës si ofrues i shërbimeve të energjisë elektrike (Furnizues), rezulton se kjo gjykatë nuk është kompetente për ta gjykuar padinë e paditësit, sepse çështja për të cilën paditësi ka paraqitur padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore të kësaj gjykate por e njëjta ka të bëjë me kontestin në mes konsumatorit dhe furnizuesit, e cila kompetencë i takon ZRRE-së si institucion administrativ e që nënkupton se paditësi, kërkesën e tij mund ta drejtoj në këtë procedurë administrative.

Vendimi si në dispozitivin II, të këtij aktvendimi është marrë duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Andaj nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2019:234516, C.nr.669/2019, me datë 31.10.2024**

**G j y q t a r i**

---

**Leotrim Gashi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën tjetër.